Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës.....
Shtojca 1/1. Formulari i Ofertës.....
Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve
Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës.....
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike
Shtojca 6. Formulari i sasisë dhe Grafiku i lëvrimit
Shtojca 7. Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit
Shtojca 9. Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....
Shtojca 10. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak).....
Shtojca 11. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)
Shtojca 12. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)
Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontrates;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
 - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, me TVSH, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shenim : Operatori ekonomik duhet ti permbahet vkm 285 /19.05.2021 Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik, e ndryshuar me nr.710 dt.24.11.2021

Shtojca 1/1.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim me të ulët*]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shenim : Operatori ekonomik duhet ti përmbahet vkm 285 /19.05.2021 Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik, e ndryshuar me nr.710 dt.24.11.2021

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikujt të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					

Datë _____	
------------	--

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
SPECIFIKIMET TEKNIKE****Objekt i prokurimit:“Blerje karburanti nafte dhe benzine ,Agjencia e Puneve Publike dhe Mirembajtjes.**

Specifikimet e mëposhtme i referohen Direktivës Europiane të lëndëve djegëse 98/70/EWC, Amendamentit 2003/17/EC, Amendamentit 2009/30/EC dhe 2011/63/EU si dhe Aneksit 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndës djegëse benzinë dhe diezel”.

Nr	Emërtimi	Njësia	Kufijtë e lejuar		Metoda e Testimit
			Min	Max	
1	Numri i Cetanit		51	—	SSH EN ISO 5165 SSH EN 16144 SSH EN 5195 EN 16715
2	Indeksi i Cetanit		46.0	—	SSH EN ISO 4264
3	Densiteti në 15°C	Kg/m ³	820	845	EN ISO 3675 dhe 12185
4	Hidrokarbure Aromatike Policiklike	% (m/m)	—	8	SSH EN ISO 12916
5	Përmbajtja e Squfurit	mg/kg	—	10.0	SSH EN ISO 20846 SSH EN ISO 13032 SSH EN ISO 20884
6	Përmbajtja e Manganit, nga 01.01.2014 e në vazhdim	mg/l	—	2	SSH EN ISO 16576
7	Pika e Ndezjes	°C	Mbi 55		SSH EN ISO 2719
8	Mbetje Karboni	% (m/m)	—	0,30	SSH EN ISO 10370
9	Përmbajtja e Hirit	% (m/m)	—	0,01	SSH EN ISO 6245
10	Përmbajtja e Ujit	mg/kg	—	200	SSH EN ISO 12937
11	Kontaminimi Total	mg/kg	—	24	SSH EN ISO 12662
12	Gryerja e shiritit të bakrit (3 orë në 50 ⁰ C)	grada	KLASI I		SSH EN ISO 2160
13	Përmbajtja e acidit të ngopur metilester	% (vV/V)	—	7	SSH EN 14078
14	Qëndrueshmëria e oksidimit	g/m ³ h	20	25	SSH EN ISO 12205 SSH EN 15751

15	Lubrifikimi, diametrik i veshjes së mprehtë (ësd 1,4) në 60 °C	um(microm)	—	460	SSH EN ISO 12156-1
16	Viskozitetit në 40⁰ C		2,000	4,500	SSH EN ISO 3104
17	Destilimi % vol e destilati qe vlon deri ne 250°C % vol e destilati qe vlon deri ne 350°C Distilati qe vlon ne 95 % vol.	%(v/v) %(V/V) °C	85	<65 360	SSH EN ISO 3405 SSH EN ISO 3924

Të dhënat teknike të benzinës pa plumb i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit që ka statusin e standardit shqiptar (SSH) 228:2012+A1:2017, sipas tabelës.

Nr.	Treguesi cilësor	Njësia e matjes	Kufijtë e lejuar	
			Minimale	Maksimale
1	Numri i oktanit kërkimor NOK		95,0	-
2	Numri i oktanit motorik NOM		85,0	-
3	Përmbajtja e Plumbit	mg/l	-	5,0
4	Densiteti (në 15 °C)	kg/m ³	720,0	775,0
5	Përmbajtja e squfurit	mg/kg	-	10,0
6	Përmbajtja e magnezit	mg/l	-	6,0 2,0
7	Stabiliteti ndaj oksidimit	minuta	360	-
8	Përmbajtja e rreshirave faktike (të lara në tretës)	mg/100ml	-	5
9	Korrezioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	renditje	Klasa 1	
10	Pamja e jashtme		E pastër dhe e tejdukshme	
11	Përmbajtja e tipit të hidrokarburit -Olefinat -Aromatiket	%) (V/V)	- -	18,0 35,0
12	Përmbajtja e benzenit	%) (V/V)	-	1,00
13	Përmbajtja e oksigjenit	%) (m/m)	-	2,7
14	Përmbajtja e komponimeve oksigjenore Methanol (alkol metilik) Etanol (alkol etilik)	%) (V/V	- -	3,0 5,0
15	-alkol iso- propilik -alkol iso – butilik - alkol terc – butil - etere (me 5 ose më shumë atome C) h	mg/l	- -	Përzierja në vëllim i kufizuar në 2,7 % (m/m) të O ²

Plotësimi i kërkesave të mësipërme, përveç deklarimit nga ana e operatorit ekonomik, do të shoqërohen edhe me flet-analizën përkatëse e cila do të konsiderohet e rregullt dhe e vlefshme,

vetëm nëse analiza është kryer nga një laborator shtetëror apo i autorizuar i tij, dhe në përputhje me Standartin SSH EN 590:2013+A1:2017 të rinovuar me (SSH EN 590:2022) ose ekuivalente.

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë në çdo ditë të javës me kartë elektronike.
- Subjekti fitues duhet të marrë përsipër prodhimin e kartave elektronike të personalizuar si dhe të ofrojë programin kompjuterik që mundëson furnizimin me karburant të mjeteve me targën e automjeteve të autoritetit kontraktor. Kartat elektronike duhet të jenë pa skadencë dhe të jenë të përdorshme deri në perfundim të vlefshmerisë së kontratës. Kjo bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesitë e qeverisjes së përgjithshme” sipas të cilit Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të kryhet nëpërmjet kartës elektronike (Deklaratë nga subjekti ofertues).

Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara më sipër në mënyrë elektronike, nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), është kusht skualifikimi.

- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.

-Fatura tatimore e shitjes e lëshuar nga operatori ekonomik duhet të shoqërohet me:

- Raport analizimi Tregu i brendshëm nga laboratorit i kontrollit të Naftës dhe Gazoilit
- Strukturën e llogaritjes së çmimit për litër.

-Operatori ekonomik ofertues duhet të garantojë furnizimin me karburant sipas standarteve shtetërore në fuqi S.SH.EN 590:2022 për Gazoil (10 ppm ULSD) (ose ekuivalente e saj) të vlefshme në pika shitje karburanti (me shërbim 24 orë, çdo ditë të javës), të vendosura në Bashkinë Mirditë , si dhe sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor furnizimin me karburant me shërbim 24 orë, me targën e automjetit të autoritetit kontraktor.

- Duhet të ketë stacione të tregtimit me pakicë të karburantit në territorin e bashkisë Mirditë, të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale qeraje, akt pronësie ose të pasqyruara në ekstraktin e QKB-së).

-Ofertuesi duhet të marrë përsipër dhe garantojë gjithçka sa më sipër të cilësojë, vend-ndodhjet dhe adresat e sakta të tyre, numrat e telefonit dhe personi i kontaktit. Informacioni për pikat e furnizimit duhet të jetë njëkohësisht i verifikueshëm nëpërmjet ekstraktit të QKR-së.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e pritshme e mallit që kërkohet:

Kerkohen gjithsej 58 186 litra Gazoil (Diesel) - 10 ppm USLD si dhe 641 litra benzine.

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia
2	Blerje karburant naftë për nevoja të APPM, Bashkia Mirditë	Litra	58186
2	Blerje karburant benzin për nevojat e APPM, Bashkia Mirditë	Litra	641
SHUMA			

Afatet e lëvrimit:

Afati i lëvrimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës e në vazhdim sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

Shënim:

- Sasitë e kërkuara nga AK, janë sasi të pritshme, e llogaritur në bazë të dhenave nga Drejtoria e Doganave të publikuar në buletin. Kjo sasi mund të jetë e ndryshueshme në varësi të cmimit të publikuar nga APP në buletin javor.
- Do të jetë AK ajo që do të përcaktojë sasitë përkatëse gjatë zbatimit të kontratës. Operatorët do të ofertojnë me marzh fitimi të shprehur në lek për liter. Ky marzh do të jetë i pandryshuar gjatë gjithë realizimit të kontratave. Sasia e kërkuar nga autoriteti është sasi e pritshme, për të cilën autoriteti do të shprehet në momentin e nënshkrimit të kontratës.
- Formulari i ofertës të përfshijë element si më poshtë:**
 - çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletin e Njoftime Publike;
 - elementet fiskale;
 - normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.”
- Gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gasoil, benzol dhe karburant për ngrohje, vlera absolute e normës së fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve. Nëse çmimi gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gasoil, benzol dhe karburant për ngrohje ndryshon në raport me çmimin e kontratës, atëherë autoritetet/entet kontraktore duhet të bëjnë likuidimin e mallit sipas faturave periodike të shitjes, mbështetur në çmimin e bursës të publikuar në Buletin e Njoftimeve Publike, i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment

Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit duhet të kontrollojë përqindjen e pranuar të rritjes apo të uljes të çmimit të bursës, të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, në momentin e shtijes së mallit, objekt kontrate, autoriteteve kontraktore, si dhe cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë të cilën është shpallur fitues kontraktori.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 8**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c. Formulari i ofertes, sipas shtojcës 1/1;
(referuar vkm 285 dt.19.05.2021, ndryshuar me vkm nr.710 dt.24.11.2021)

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Sipas kritereve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 8).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim xhiroje vjetore nga Administrata Tatimore për 3 (tre) vitet e fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kjo kerkese konsiderohet e përmbushur nëqoftëse Operatorët Ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK si më lart.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare perkatësisht 2020,2021 dhe 2022, Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti OE duhet te paraqese kopje te bilanceve te tre viteve te fundit te paraqitur prane autoritetit perkates te konfirmuara nga ky autoritet.Kjo kerkese konsiderohet e përmbushur nese ne dy bilance te njepasnjeshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivit.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet që dëshmojnë se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet përkatëse**, për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, në vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitetet për vitin 2023, sipas ligjit 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së perlllogaritur të kontratës që prokurohet (neni 55/4/b i vkm-se 285/2021)

a. Kjo pikë përmbushet me vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.4 Subjekti Ofertues duhet të disponojë minimalisht 1 (një) stacion të tregëtimit me pakicë të karburantit brenda territorit të Bashkisë Mirditë, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB-së, etj).

- Ky stacion furnizimi të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B (*sipas shtojces I të ligjit 52/2020, Veprimtaria: Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane, Kapaciteti kufi për lejet e tipit B - Të gjitha instalimet*), Vërtetim Teknik të leshuar nga Organet e Miratuara të Vlersimit të Konformitetit (OMVK) ose nga një shoqëri e akredituar, Certificate e mbrotjes nga zjarri leshuar nga M.Z.SH dhe Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributoret e shitje me pakice, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë datën e hapjes së ofertave.

2.3.5 *Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje tregtimi/ Autorizim për tregëtim karburantesh me pakice (Gazoil/Diesel), sikurse përcaktohet në (VKM-në me nr.538 datë 26.05.2009, vkm 970 date 02.12.2015, Ligji nr.8450 dt.24.02.1999)*

2.3.6 Subjekti ofertues duhet të paraqesë **dhe deklaratat si me poshte:**

- Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se ofron një faqe të menaxhimit të karburanteve (webpage) ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet duke përdorur kartën elektronike.

Kjo faqe e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, dhe nga llogaria elektronike e AK në mjetet e transportit, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti Kontraktor.

Mosofrimi i faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), përbën kusht për skualifikim.

- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë në shërbim 24 orë në çdo ditë të javës, me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, deri në përfundim të afateve të efektivitetit të kontratës; (*Deklarate nga subjekti ofertues.*)

-
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike. (*Deklarate nga subjekti ofertues.*)

2.3.8 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Flete/Raport analize për tregun e brendëshëm, për cilësinë e karburantit, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) nga një laborator i çertifikuar në Republikën e Shqipërisë i cili verteton se produkti është në përputhje me standartet e miratuara i lëshuar jo më përpara se 60 ditë nga data e hapjes së ofertave.*

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Vërtetim nga organet e miratuara të Vleresimit të Konformitetit (OMVK) , që të provojë se ka importuar dhe /ose ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit Shqiptar dhe ofertuesi nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë të karburantit, për vitin 2023.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor

Ne respektim të nenit 36, 37 të LPP-se ne të gjitha rastet kur përmendet “marke” përfshihet termi “ekuivalent”.

Sqarim për ofertuesit: Ne respektim dhe zbatim të **Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 26 neni 39**, Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranon si provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 të VKM nr.285, date 19.05.2021, i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 neni 26 i VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I, Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I:

Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-.</p>	
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</p>	<p>_____</p>

1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklaratë;	Po []
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po []
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po []
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po []
5. Për efekt të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që: a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	Po []
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [] Jo []
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë	Po [] Jo []

<p>emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit).</p>	
<p>8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me :</p> <p>a) çmimet;</p> <p>b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;</p> <p>c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose</p> <p>d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.</p>	<p>Po [] Jo []</p>
